

20 maj 2023

# DEKLARATË

Pas qëndrimit për rreth 1 muaj i shtruar në gjendje të rëndë shëndetësore në Spitalin Universitar Nënë Tereza, shtetasi J.R. ndërroi jetë këtë të shtunë, datë 20 maj 2023.

Centre for Legal Empowerment ka qënë që nga dita e parë në ndjekje dhe në përfaqësim të kësaj çështjeje për komunikimin me transparencë që institucionet publike, ligjore, spitalore, të vuajtjes së dënimit etj, kanë për detyrë t'ia japin familjarëve, publikut dhe përfaqësuesve ligjor.

Shtetasi J.R. u arrestua nga Policia e Shtetit për vjedhje dhe pas qëndrimit për disa ditë në paraburgim u dërgua në gjendje të rëndë shëndetësore në Spital, ku pas 1 muaji humbi dhe jetën.

Gjatë kësaj periudhe CLE, ka evidentuar një sërë shkeljesh ligjore nga ana e institucioneve dhe organeve të përfshira.

1. Shtetasi J. R. për shkak të emergjencës shëndetësore është transportuar në spitalin "Nënë Tereza", ku dhe është shtruar në ambientet e spitalit në datën 17.04.2023, ndërkohë që Znj. P. R. (nëna e J. R.) është njoftuar në datën 28.04.2023, pra 11 ditë më vonë, ndërkohë që ligji parashikon se në rastet e dëmtimeve serioze të paraburgosurit, IEVP-ja, njofton menjëherë familjarët ose të afërmit e të paraburgosurit.
2. Autoritetet e IEVP 313, nuk kanë pranuar që ta marrin në dorëzim për shkak të mbingarkesës në këtë institucion dhe në këto kushte ai është rikthyer dhe vendosur përsëri në Bllokun e Sigurisë Tiranë, ndërkohë që ligji parashikon se i paraburgosuri i nënshtrohet një vizite ekzaminuese dhe interviste mjekësore nga ana e mjekut të institucionit.
3. CLE në cilësinë e përfaqësuesve ligjor të nënës së shtetasit J.R. ka dërguar në datë 2 maj, elektronikisht dhe dorazi, kërkesa për informacion drejtuar 3 institucioneve kryesore, Drejtorisë Vendore të Policisë Tiranë, Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, Spitalit Universitar Nënë Tereza Tiranë. Kërkesat për informacion është ridërguar për Drejtorinë Vendore të Policisë Tiranë në datë 15 maj si pasojë e mos marrjes së një përgjigjeje. Ende nuk ka një përgjigje në lidhje me kërkesat e paraqitura.

Shkeljet e mësipërme janë bazë për dyshim të arsyeshëm që mospërmbushja e detyrimeve ligjore për ekzekutimin e vendimit penal që ka vendosur masë sigurie "arrest në burg" nga ana e Drejtorisë Vendore të Policisë Tiranë dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve ka dëmtuar shëndetin duke rezultuar në shtrimin e tij në spital ku ai dhe ndërroi jetë.

*CLE, do të vazhdojë ndjekjen e çështjes deri në zbardhjen e të gjitha rrethanave të ngjarjes.*